

Prishtinë

RAPORTI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

17.03.2026

Për: Delegatët e Kuvendit të Punës së Federatës së Badmintonit të Kosovës (BFK-së)

Nga: Këshilli Mbikeqyres i BFK-së

Lënda: Raport

Te nderuar,

Mbështetur në mandatin e Këshillit Mbikeqyrës të Federatës së Badmintonit të Kosovës (BFK), në përbërje Arlind Behluli kryetar, Avni Bllaca, dhe Naim Murtezi , anetar, Këshilli Mbikeqyres BFK, në koordinim me Kryetarin e BFK, siq përcaktohet me dispozitat e Statutit të BFK, pas realizimit të vizitave mbikeqyrese që kanë të bëjnë me punën ligjshmërinë dhe me veprimtarinë materialo - financiare të Federatës së badmintonit të Kosovës në vazhdim paraqesim këtë:

RAPORT

- Këshilli Mbikeqyrës i BFK në përbërje të plote, ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm, ka realizuar takime me kryetarin e BFK, z. Lulzim Haziri dhe sipas nevojës me stafin e tij, me qëllim të diskutimit të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2025, si dhe me qëllim të shqyrtimit të aspekteve të tjera që lidhen me qështje financiare e ligjore të këtij institucioni.
- Përveq raportimit të kryetarit të BFK, Këshillit mbikqyrës, ka analizuar dhe shqyrtuar edhe Raportin e Punës për vitin 2025, Raportin e Auditorit me Pasqyra Financiare për vitin 01.01.2025 deri më 31 dhjetor 2025.
- Këshilli Mbikeqyres, ka analizuar dhe shqyrtuar veprimtarinë e përgjithshme dhe krahasuar dokumentet relevante të cilat ka konsideruar si të nevojshme për konstatim të përgjithshëm të punës dhe veprimtarisë së BFK-së për gjatë vitit 2025 dhe ka arritur në përfundim se:

1. Pasqyrat financiare janë raportuar sipas standardit të kërkuar dhe të njëjtat janë evidentuar në mënyrë të rregullt;

2. Ne krahasim me vitet paraprake, BFK ka arritur qe formen e raportimit te shpenzimeve financiare ta avancoj edhe me tutje;
3. Keshilli Mbikqyres nuk ka arritur te gjejë ndonje shkelje te natyres juridike;
4. Në bazë të analizës së bërë, Këshilli Mbikqyrës vie në përfundim se Federata e badmintonit e Kosovës ka arritur që të bëj progres të dukshëm në masivizimin e sportit të badmintonit në Kosovë,
5. Përveq tjerash Këshilli Mbikqyrës vlerëson punën e kryetarit Haziri dhe bordit ekzekutiv në realizimin e aktiviteteve, si dhe në arritjen e pjesmarjes në gara ndërkombëtare si në pjesmarja në
 - Kampionatin Internacional për kadet U-17 në Pazardgjik Bullgari,
 - Pjesmarjen në kampionatin internacional Valamar Croatia Open 2025.
 - Turneu ballkanik Youth Turkie Internacional U-19
 - Garat internacionale IV U17 PORTUGAL OPEN 2024 “ Caldas da Rainha-Portugal
 - Mbajtjen e kampit në Stamboll të Turqis me qëllim të përmbushjes së objektivave të Federatës së Badmintonit të Kosovës.
 - Pritjen e kryetarit të BEC-it dhe atë të Federates Turke nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me COMEBA,
 - Pjesmarjen në konferencen botrore për trajner në Paris dhe shumë aktivitete tjera.

Përveq sportit ndërkombëtar Federata ka zhvilluar edhe aktivitete nacionale në tre kategori dhe ate Kampionatin Individual, Double, Miks, Top 5 në Pranverë dhe vjeshtë, pastaj ka blerë paisje profesionale me reketa , dresa trenerka dhe 4 complete shtylla gjë që korospodon me fatura të rregullta.

Federata ka bërë edhe trajnimin për administratorë të sportit .

Kosova senzibilizohet edhe më shumë dhe është pjesë e medimeve botërore të badmintonit BWF ku plasohen informata të rëndësishme për federaten në fjalë. Këshilli mbikqyrës ka konstatuar se janë zhvilluar një sër aktivitetesh që rezultojnë me shpenzimet e arësyeshme dhe si të tilla pranohen dhe korospodojnë me hargjimet. Këshilli mbikqyrës rekomandon se BFK-ën nën menaxhimin e Hazirit në aspektin strategjik sheh ngritjen avancimin dhe masovizimin e badmintonit në Kosovë. duke krijuar klube të reja në qendra të mëdha sin ë Ferizaj, Prizeren e Mitrovicë gjë që është më se e nevojshme badminton të shtrihet në tër teritorin e Kosovës.

Andaj duke vlerësuar arritjet e gjeritanishme Këshilli Mbikqyrës konstaton se BFK-ja edhe përkundër buxhetit të vogël dhe vonesave të alokimit të vonshëm të mjeteve nga MKRS, kanë arritur ti përmbushin obligimet për TM1, TM2, TM3, dhe TM4 i cili është në proces të mbylljes andaj konstatojmë se kan obligime shtesë të cilat janë bartur për vitin 2026 përshkak të buxhetit të pamjaftueshëm kontributet e pagave për muajin e 12 janë të papaguara dhe një sër faturash të cilat duhet paguar gjatë vitit 2026. sipas kryetarit Haziri dhe Sekretarit Blerim Sylejmani me shpresën se viti 2026 do të jet viti zhvillimit dhe prosperimit të sportit të badmintonit në Kosovë dhe më gjërë. Ku Kosova do të merë pjesë në Lojërat mesdhetare në Otronto të Italisë me dy garues.

Në emërte keshillit mbikqyrës



Arlind Behluli

